



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.32, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES
“KËRKESË PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË
LEJES/AUTORIZIMIT” DHE SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE
HEC “NDËRFUSHAS” TË SHOQËRISË “SGD ENERGJI” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Korigjimin e koordinatave të lejes nr.prot.91, datë 08.05.2017 miratuar me vendimin nr.10, datë 27.04.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat si më poshtë:

HEC “Ndërfushas”

Koordinatat e Veprës së Marrjes do të ndryshohen si më poshtë:

Nga: VM (Gauss Kruger)

- X= 4437738.19; Y= 4584319.47; Z= 1056.6 m.m.n.d.

Në : VM (KRGJSH)

-X= 521199.03; Y= 4583962.73; Z= 1056.6 m.m.n.d.

Koordinatat e Godinës së Centralit do të ndryshohen si më poshtë:

Nga: GC (Gauss Kruger)

- X= 4437183.15; Y= 4585378.45; Z= 911.6 m.m.n.d.

Në : GC (KRGJSH)

- X= 520625.71; Y= 4584835.48; Z= 911.6 m.m.n.d.

2. Miratimin e rinovimit të lejes me koordinatat e korigjuara si më sipër për përdorim burimi ujq sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike me Nr.91 prot., datë 08.05.2017 miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.10, datë 27.04.2017 "HEC Ndërfushas", subjektit "SGD Energji" sh.p.k., me vendndodhje, përroi i Sharrës, degë e lumit Mat, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sipas këtyre koordinatave:

3. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujq (përroi i Sharrës)

HEC "Ndërfushas"

Vepra e marrjes

- X= 521199.03
- Y= 4583962.73
- Z= 1056.6 m.m.n.d

Godina e Centralit

Pika e shkarkimit

- X= 520625.71
- Y= 4584835.48
- Z= 911.6 m.m.n.d

- $Q_{mes}=0.17 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{llog}=0.95 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{eko}=0.0175 \text{ m}^3/\text{s}$

- Fuqia max e instaluar N= 1125 kW

- Energjia Vjetore E=3,673,186 kWh/vit.
- 4. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë prodhimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës, plotësimin e nevojave për ujitje, sipas kërkesave të organeve të vetëqeverisjes vendore, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
- 5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

